




KOLEGJI - COLLEGE  
**PJETËR BUDI**  
Prishtinë - Prishtina



---

## KOLEGJI “PJETËR BUDI” – PRISHTINË

### RR E G U L L O R E

Mbi punën e Bordit Drejtues të Kolegjit “Pjetër Budi” – Prishtinë

Prishtinë, 2020



Në bazë të neneve 19 të Statutit, Bordi Drejtues i të Kolegjit “*Pjetër Budi*” – Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.12.2020 miratoi:

## **R R E G U L L O R E**

### **Mbi punën e Bordit Drejtues të Kolegjit “Pjetër Budi” – Prishtinë**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Bordit Drejtues të Kolegjit “*Pjetër Budi*” – Prishtinë nga ftesa për takim, mbajtja e takimit, mënyra e vendosjes dhe implementimi i vendimeve si dhe çështjet tjera përkatëse.

#### **II. VERIFIKIMI I MANDATIT TË ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES**

##### **Neni 2**

Takimin konstituiv i Bordit Drejtues e thërret themeluesi i Kolegjit, i cili e kryeson atë derisa të zgjidhet Presidenti i Bordit Drejtues.

##### **Neni 3**

- 3.1. Në takimin e parë, Bordi Drejtues e verifikon mandatin e anëtarëve të vet në bazë të raportit të sekretarit të përgjithshëm, në lidhje me rregullsinë e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit Drejtues nga Senati.
- 3.2. Raporti votohet nga të pranishmit.
- 3.3. Nëse Bordi Drejtues konstaton se emërimet nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ose nëse ekziston ndonjë konflikt interesi për një apo më shumë anëtarë të Bordit Drejtues, atëherë kërkon nga Senati Akademik që brenda afatit prej dy javësh të bëjë zgjedhjet e reja për pozitat e kontestuara.
- 3.4. Në rast të kontestimit të zgjedhjeve apo emërimeve, takimi konstituiv i Bordit Drejtues ndërpritet derisa zgjedhjet apo emërimet të jenë përsëritur në mënyrë të suksesshme.

##### **Neni 4**

4.1. Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e pranishëm të Bordit Drejtues e nënshkruajnë deklaratën me tekstin si vijon: “Deklaroj se do të kryej detyrat me nderë dhe besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, se do të kontribuoj në përmbushjen e detyrave të Bordit Drejtues, se do ta ushtroj mandatin tim me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do të përfaqësoj me përkushtim interesat e Kolegjit dhe se do të përmbahem Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Statutit dhe akteve tjera normative të Kolegjit.





### **III. ZGJEDHJA E PRESIDENTIT DHE ZËVENDËSPRESIDENTIT TË BORDIT DREJTUES**

#### **Neni 5**

- 5.1 Bordin drejtues, në mbledhjen e parë konstituive e zgjedh Presidentin e Bordit prej anëtarëve të vet me të drejtë vote. Zgjedhja e presidentit të bordit bëhet me shumicë absolute të votave të të gjithë anëtarëve të Bordit me të drejtë vote ( minimum 3 vota, nga 5 anëtarë me të drejtë vote)
- 5.2 Zëvendëspresidenti zgjidhet me shumicën e votave nga radhët e anëtarëve të emëruar nga Senati Akademik

### **IV. TAKIMET E BORDIT DREJTUES**

#### **Neni 6**

- 6.1. Takimet e Bordit Drejtues i thërret dhe i kryeson Presidenti i Bordit Drejtues.
- 6.2. Në rast të mungesës së presidentit, mbledhjen e kryeson zëvendëspresidenti. Nëse edhe zëvendëspresidenti nuk është prezent në takim, takimin e kryeson anëtari më i vjetër i Bordit Drejtues.
- 6.3. Presidenti i thërret takimet sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, Takimet e Bordit Drejtues mbahen më së paku në çdo pesë javë.
7. Takimet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarë do kohe sipas proceduarve të parapara. Rendi i ditës për këto takime duhet të jetë i kufizuar me një ose maksimum dy pikë kryesore. Gjatë takimit së Bordit Drejtues mund të vendoset për thirrjen e ndonjë takimi të ardhshëm të Bordit. Në këto raste, anëtarëve të Bordit që nuk janë të pranishëm duhet t'u dërgohen ftesat për takim.
8. Në rast të shkarkimit të presidentit dhe të zëvendëspresidenti, anëtari më i vjetër i Bordit Drejtues e organizon procedurën e zgjedhjes pa asnjë vonesë.
9. Takimet e Bordit Drejtues janë të mbyllura për publikun, përveç rasteve kur Bordin Drejtues vendos ndryshe.
10. Anëtarët e Bordit Drejtues do të ftohen më së paku tri ditë para takimit. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me fax, me e-mail ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurt.
11. Presidenti ka të drejtë në çfarëdo kohe që të ftojë në takim ekspertë ose persona të tjerë.
12. Presidenti është i obliguar të thërrasë takimin e Bordit Drejtues nëse këtë e kërkojnë së paku 2/3 të anëtarëve dhe nëse qëllimi i mbajtjes së takimit është arsyetuar me shkrim.
13. Nëse presidenti/zëvendëspresidenti i Bordit Drejtues nuk i përgjigjet kërkesës e së paku 2/3 të anëtarëve për thirrjen e takimit brenda afatit prej tri ditësh, takimin e thërret anëtari më i vjetër i Bordit Drejtues.

#### **Neni 7**

- 7.1. Të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues janë të obliguar të marrin pjesë në takimet e Bordit.
- 7.2. Anëtarët e Bordit Drejtues votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.
- 7.3. Para se të fillojë takimi i Bordit Drejtues, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Bordit Drejtues mund të mungojë nga takimi për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në takim, anëtari i Bordit duhet të njoftojë me kohë Presidentin.



- 7.4. Rektori, Sekretari i Përgjithshëm dhe kryetari i Parlamentit studentor janë anëtarë të Bordit ex officio pa të drejtë vote.
- 7.5. Kryetari i Parlamentit të Studentëve mund të marrë pjesë në takimet e Bordit Drejtues, pa të drejtë vote, kur trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me studentët. Pjesëmarrja koordinohet paraprakisht me Presidentin e Bordit Drejtues.

### **Neni 8**

- 8.1. Presidenti e kryeson takimin nga hapja deri në përfundim të takimit.
- 8.2. Për përgatitjen e materialeve për takimin e Bordit Drejtues kujdeset Presidenti në bashkëpunim me zëvendës-presidentin, të cilit i ndihmojnë sekretari i përgjithshëm dhe rektori.
- 8.3. Në fillim të takimit, presidenti konstaton se a ka kuorum, e propozon rendin e ditës, e hap diskutimin rreth rendit të ditës, e konstaton miratimin e rendit të ditës.
- 8.4. Presidenti ia jep fjalën diskutuesit, e konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, e konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në takim, e konstaton përfundimin e takimit dhe ndërmerr veprime të tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e takimit sipas kësaj rregulloreje.
- 8.4. Anëtarët e Bordit Drejtues kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin.
- 8.5. Materialet ose kërkesat, të cilat bashkëngjiten gjatë takimit, mund të miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote.

### **Neni 9**

- 9.1. Pas miratimit të rendit të ditës kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
- 9.2. Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet presidenti ose personi i caktuar nga ai, pas të cilit presidenti e hap diskutimin.
- 9.3. Të gjithë anëtarët e pranishëm të Bordit Drejtues mund të marrin pjesë në diskutim dhe të paraqesin mendimet, propozimet lidhur me çështjet, të cilat do të vendosen në takim.
- 9.4. Presidenti e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim.
- 9.5. Presidenti është përgjegjës për respektimin e Rregullores së punës, për veprimet dhe sjelljen e anëtarëve sipas rendit.
- 9.6. Presidenti ka të drejtë ta ndërpresë takimin, nëse ai konstaton se nuk ka kushte normale për mbajtjen e saj.

### **Neni 10**

Bordi Drejtues, në bazë të propozimit të presidentit apo të ndonjë anëtari tjetër, mund të vendos që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për takimin e ardhshme.





### Neni 11

- 11.1. Për mbajtjen e rendit në takime kujdeset presidenti.
- 11.2. Presidenti dhe pjesëmarrësit në takimin e Bordit Drejtues janë të obliguar që t'i përmbahen kësaj rregulloreje.
- 11.3. Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
  - a) Vërejtje,
  - b) Marrja e fjalës, dhe
  - c) Largimi nga mbledhja

### Neni 12

- 12.1. Vërejtje me gojë mund t'i shqiptohet të pranishmit, nëse me sjelljen dhe diskutimin e tij e çrregullon dhe e pengon punën normale të takimit.
- 12.2. Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit të Bordit Drejtues, i cili me sjelljet dhe deklaratat e tij e çrregullon punën normale të Bordit Drejtues, për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtje.
- 12.3. Vërejtjen dhe marrjen e fjalës ia shqipton presidenti.
- 12.4. Largimi nga takimi i shqiptohet pjesëmarrësit, nëse edhe pas marrjes së fjalës e pengon mbarëvajtjen e takimit.
- 12.5. Largimin nga takimi e shqipton Bordi Drejtues me shumicë votash. Pjesëmarrësi, të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë ta lëshojë takimin. Largimi bëhet vetëm për atë takim.

### Neni 13

- 13.1. Çdo anëtar i Bordit Drejtues ka të drejtë të parashtojë kërkesë-ankesë për temën e caktuar.
- 13.2. Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa-ankesa të parashikohet me shkrim.

## V. VENDOSJA, VOTIMI DHE ZGJEDHJET

### Neni 14

- 14.1 Për mbajtjen e mbledhjeve të Bordit drejtues nevojitet kuorumi prej pesë anëtarëve ( prej të cilëve së paku 3 anëtarë duhet te jene me të drejtë vote).
- 14.1. Para se të votohet, presidenti e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- 14.2. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve sipas pikës së rendit të ditës, Bordi Drejtues merr vendim ose konkluzion sipas pikës së rendit të ditës.
- 14.3. Bordi Drejtues i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e presidentit është vendimtare.



- 14.5. Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose për propozimet nga organet e kolegjit, e pastaj për propozimet e tjera.
- 14.6. Votimi bëhet i hapur me ngritje dore ose me vota të fshehta. Për mënyrën e votimit Bordi Drejtues vendos në takimin përkatëse, nëse me Statutin e Kolegjit nuk është paraparë ndryshe.
- 14.7. Votimi bëhet: "për", "kundër" dhe "abstenim".

#### **Neni 15**

- 15.1. Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i formuar nga Bordi, në përbërje prej tre anëtarëve. Së paku një anëtar i këtij komisioni duhet të jetë nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Senati.
- 15.2. Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, presidenti konstaton se propozimi i vendimit ose konkluzioni është miratuar ose është refuzuar.

### **VI. ZGJEDHJA E REKTORIT**

#### **Neni 16**

- 17.1. Rektori zgjedh Bordi drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional prej tre (3) anëtarëve të cilin komision e formon Senati akademik. Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikoj nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.
- 17.2. Rektori zgjidhet me votim të fshehtë nëpërmjet fletëvotimeve. Fletëvotimi do të përmbajë të gjithë kandidatët e përcaktuar në listën e komisionit profesional. Secili anëtar i Bordit Drejtues ka të drejtë ta rrumbullakojë një kandidat në fletëvotim. Fletëvotimet që kanë të rrumbullakuar më shumë se një kandidat do të konsiderohen të pavlefshme. Numri total i votave numërohet për secilin kandidat. Kandidati, i cili arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote zgjidhet rektor.
- 17.3. Nëse asnjë kandidat nuk e arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e parë, dy kandidatët me numër më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë.
- 17.4. Nëse asnjëri prej dy kandidatëve nuk shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në tri radhë të njëpasnjëshme të votimit, procedura e zgjedhjes do të përsëritet nga fillimi siç është e paraparë me Statut, d.m.th. me shpalljen e konkursit për pozitën e rektorit.
- 17.5. Bordi Drejtues ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga komisioni profesional.

### **VII. PROCESVERBALI NGA TAKIMI I BORDIT DREJTUES**

#### **Neni 17**

- 17.1. Në çdo takim të Bordit Drejtues mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga presidenti dhe procesmbajtësi.
- 17.2. Procesverbali duhet t'i përmbajë këto elemente:
  - Vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të takimit;
  - Rendin e ditës;





- Listën e pjesëmarrësve dhe të atyre që mungojnë;
- Të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse, dhe
- Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e takimit.

17.3. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas takimit të Bordit drejtues dhe duhet tu dërgohet anëtarëve të bordit me rasti në dërgimit të materialeve për takimin e ardhshëm të Bordit.

17.4. Procesverbali miratohet në takimin e ardhshëm të Bordit.

17.5. Procesverbali ruhet në arkivin e Kolegjit.

## **VIII. KOMISIONET E BORDIT DREJTUES**

### **Neni 18**

18.1. Komisionet janë organe ndihmëse të Bordit Drejtues.

18.2. Komisionet formohen nga Bordi Drejtues në pajtim me Statutin e Kolegjit dhe e ndihmojnë Bordin në lidhje çështjet e veçanta të punës së tij.

## **IX. AKTET E BORDIT DREJTUES**

### **Neni 19**

19.1. Bordi Drejtues miraton dhe nxjerr:

- Statutin e Kolegjit;
- Rregullore;
- Vendime;
- Konkluzione;
- Rekomandime.

19.2. Bordi Drejtues jep interpretim autentik të akteve që miraton.

19.3. Procesmbajtësi është i obliguar që t'i përgatisë vendimet dhe rekomandimet nga takimi i Bordit Drejtues, ndërsa rregulloret i përgatit komisioni përkatës i formuar enkas për këtë çështje.

### **Neni 20**

Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë për të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues dhe personave të tretë të ftuar ose të angazhuar në procedurat e Bordit Drejtues.

### **Neni 21**

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Kolegjit dhe Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

## **XII. DISPOZITAT KALIMTARE**

### **Neni 22**



- 
- 22.1. Për zbatimin e drejtë të kësaj rregulloreje kujdeset presidenti i Bordit Drejtues.
  - 22.2. Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e bën Bordi Drejtues.
  - 22.3. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi Drejtues.
  - 22.4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje pushojnë së vlejtori dispozitat juridike të rregullores e cila rregullon materien e njëjtë.

#### **Neni 2**

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje mund të bëhet sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes.

**Presidenti i Bordit**

